

Luftimet në Koshare si vend i kujtesës - Nga heshtja deri te prodhimi i mitit heroik

Marijana Stojčić

Nëse dikush ka nja dhjetë vjet pa shkuar në Serbi dhe Beograd, përveç monumenteve të ndryshme të sapovendosura që shfaqen pothuajse çdo ditë, në parkun përballë spitalit „Dr Dragiša Mišović“, ndoshta do të vërejë edhe një - *Monument të Heronjve të Koshares*.

Duke vënë re kurorat dhe lulet, ndoshta do ta kërkojë në internet për të kuptuar se për çfarë monumenti bëhet fjalë. Ajo që do të gjejë fillimisht me shumë gjasa është një artikull në *Wikipedia* me informacionin se ky është monumenti qendror i luftimeve në Koshare, i zbuluar në vitin 2020 dhe se “monumenti përmban tri skulptura që përfaqësojnë ushtarët serbë në periudha të ndryshme historike. Aty paraqitet një kalorës mesjetar serb, një ushtar serb nga periudha e Luftërave Ballkanike dhe të Luftës së Parë Botërore, si dhe një pjesëtar i Ushtrisë së Jugosllavisë (UJ). Asnjë prej tyre nuk mban armë por vetëm mburojë, që thekson kështu se ata po marrin pjesë në luftërat mbrojtëse, që do të thotë se po mbrojnë vendin e tyre”. Nëse vazhdon më tej me kërkime, nga media do të mësojë se monumenti u është përkushtuar pjesëtarëve të UJ-së të rënë në vitin 1999 në Kosovë përgjatë bombardimeve të NATO-s.

Luftimet që në diskursin publik më shpesh emërtohen si Beteja e Koshares u referohen konflikteve ushtarake të zhvilluara nga data 9 prill deri më 10 qershor në kufirin jugosllavo-shqiptar, rreth kullës së vrojtimit në Koshare në shpatet e Bjeshkëve të Nemuna, afër Gjakovës dhe Deçanit.

Luftimet në Koshare filluan me sulmin e datës 9 prill 1999 kur pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të ndihmuar nga Ushtria e Shqipërisë dhe flota aeronautike e NATO-s, kaluan kufirin shtetëror në rajonin e kullës së




Monumenti i Heronjve të Koshares – Beograd. Foto: Ivica Đorđević. Burimi: Arkivi i CPI-së



Monumenti i Heronjve të Koshares – Beograd. Foto: Ivica Đorđević. Burimi: Arkivi i CPI-së

vrojtimit dhe sulmuan batalionin e 53-të kufitar të UJ-së.

Në luftimet morën pjesë edhe Brigada e 125-të e Motorizuar e UJ-së, Brigada e 63-të Parashutiste, një pjesë e Brigadës së 72-të speciale, Policia Ushtarake, një pjesë e Brigadës së 549-të të Motorizuar, pjesët e tjera të Korpusit të Prishtinës, rezervistë dhe vullnetarë të vendit dhe të huaj. Sipas deklaratës së gjeneral-majorit Dragan Zhivanović, komandantit të Brigadës së 125-të të



Media

Motorizuar të UJ-së, në rajonin e Koshares kanë humbur jetë 108 pjesëtarë të UJ-së: 18 oficerë dhe nënoficerë, 50 ushtarë të rregullt, 13 rezervistë dhe 24 vullnetarë.

Humbjet zyrtare të UÇK-së janë rreth 200 të vdekur. Pjesa më e madhe e të vrarëve të UJ-së ishin djem të rinj nga mosha 18 deri 20 të cilët ishin duke kryer shërbimin ushtarak, kryesisht nga familjet punëtore dhe fshatare. Luftimet e Koshares përfunduan zyrtarisht më 14 qershor të vitit 1999, kur Ushtria e Jugosllavisë u tërhoq edhe nga Kosharja edhe nga Kosova, në bazë të Marrëveshjes së Kumanovës me të cilën përfundoi bombardimi tremujor i Republikës së atëhershme Federale të Jugosllavisë.

Ndoshta ky kalimtar i panjohur nga fillimi i këtij teksti do ta pyesë veten papritur se si ka mundësi që nuk e ka dëgjuar kurrë më parë këtë, siç paraqitet në media të ndryshme, “historia më heroike nga lufta e Kosovës” e cila rreshtohet ndër “momentet më të ndritshme të historisë sonë ushtarake dhe kombëtare” kur pjesëmarrësit e luftimeve në Koshare “i’a thyen tehun NATO-s” dhe “parandaluan pushtimin tokësor të Serbisë”.

Megjithatë, “historia epike” e Koshares nuk është një tregim mbi (mos)-informimin personal të kalimtarëve të rastësishëm dhe më pak të rastësishëm, por është rezultat i proceseve më të gjera që zhvillohen paralelisht në nivelin e politikave shtetërore të kujtesës që nga vitet nëntëdhjetë të shekullit të XX-të, duke formësuar pas vitit 2012 një fazë të re të marrëdhënies zyrtare ndaj të kaluarës dhe të formimit të narrativit qendror mbi luftërat e viteve nëntëdhjetë.

Siç tregon hulumtimi i Qendrës për Histori të Aplikuar (CPI) nga viti 2021, “Beteja e Koshares si vendi i kujtesës - Përfaqësimi mediatik i luftimeve në Koshare në vitin 1999”, versionin e shkurtuar dhe të përpunuar të të cilit po ju prezanton ky tekst, deri në vitin 2011 ngjarjet luftarake në Koshare pothuajse nuk kanë ekzistuar fare në diskursin publik. Pas vitit 2016 kjo ato u bënë një nga momentet më të rëndësishme të politikave shtetërore të kujtesës.

Faktikisht, mediat mainstream, sidomos ato që marrin financime të konsiderueshme nga buxheti shtetëror, filluan ta njihnin Kosharen si temë me rëndësi shoqërore vetëm nga viti 2016.

Është e dukshme që shumë tekste përsëriten nëpër media të ndryshme, ndonjëherë plotësisht, dhe ndonjëherë me ndryshime minimale në formën e variacioneve të formulimeve, modifikimit të titujve, nëntitujve apo pjesëve të veçura dhe fotografive.

Kjo rritje kaq mbresëlënëse e interesimit mediatik përputhet edhe me nismat dhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me mënyrat e dëshirueshme të kujtesës kolektive që vijnë nga strukturat shtetërore. Ngritja e luftimeve të Koshares si vend i rëndësishëm i kujtesës u shoqërua edhe nga investimet e konsiderueshme të burimeve shtetërore në forma të ndryshme të përkujtimit në nivelin kombëtar dhe lokal: emërtimi i rrugëve të qyteteve të ndryshme në Serbi me emra luftëtarësh, ngritja e monumenteve dhe vendeve përkujtimore, ceremonitë dhe aktivitetet e ndryshme përkujtimore ku marrin pjesë dhe flasin zyrtarët më të lartë politikë dhe ushtarakë, organizimi i tubimeve të ndryshme dhe prezantimi i librave për Kosharen në ambientet e financuara



Dhomë përkujtimore "Viktimat e Kosmetit - Trimat e Atdheut" - Beograd (2016) Foto: Dragan Petrović. Burimi: Arkivi i CPI-së



Trilogjia "Ne mbronim Kosharen" e autorit Nenad Mikiq. Burimi: Arkivi i CPI-së



Rruga e Heronjve të Koshares - Novi Sad (2023) Foto: Dragan Petrović. Burimi: Arkivi i CPI-së



Panairi i Libri 2018: Promovimi i librit "Beteja e Koshares, kujtimet e pjesëmarrësve në 1999" në stendën e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Serbisë. Burimi: Arkivi i CPI-së



Mural Heronjtë e Koshares – Kralejë (2020). Foto: Nedžad Horozović. Burimi: Arkivi i CPI-së

nga buxheti shtetëror. Të gjitha këto aktivitete shoqërohen edhe nga financimi i projekteve kulturore siç janë projektet botuese, filmat dhe serialet dokumentare dhe artistike, në të cilat investohen mjetet e konsiderueshme publike. Kështu, për shembull, në vitin 2019 u xhirua një serial dokumentar-artistik jashtëzakonisht i shikuar "Tregimet luftarake nga Kosharja" në bashkëproduksionin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Radio Televizionit të Serbisë (RTS) duke paralajmëruar një serial dhe film

artistik. Me këngën "Zana nga Kosharja" të autorit Neven Millaković Likota, shkrimtar nga Tivari, në vitin 2019 në ceremoninë solemne u promovua gjenarata e re e kadetëve të Ushtrisë së Serbisë para ndërtesës së Asamblesë Popullore në Beograd. Videoja e këngës prodhimi i së cilës u financua nga Ministria e Mbrojtjes, u shfaq për herë të parë në vitin 2022 gjatë ceremonisë me rastin e *Ditës së Veteranëve të Luftës*, të themeluar në vitin 2015 që kur ka filluar të shënohet çdo vit në



Murali *Kush nuk mban mend bëmën e trimave të Koshares, e zëntë mallkimi i trimave të Kosovës* - Beograd i Ri. Foto: Dragan Petrović. Burimi: Arkivi i CPI-së



Tekstet mediatike. Burimi: Arkivi i CPI-së



Ivan Antiq - Fushata zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të vitit 2022. Foto: Dragan Petrović. Burimi: Arkivi i CPI-së



Libra për fëmijë: *Koshare - Beteja e re e Kosovës, Trimat serbë - Nga Beteja e Kosovës deri te Kosharja dhe Serbët kundër NATOS nga 1991 deri në 1999*. Burimi: Arkivi i CPI-së

organizimin e të gjitha njësive dhe institucioneve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ushtrisë së Serbisë.

Këta shembuj tregojnë qëllimin dhe interesin e strukturave shtetërore që të rregullojnë përmbajtjen e kujtesës kolektive dhe të imponojnë interpretimin e tyre të ngjarjeve në Koshare.

Arsyeja pse për periudhën pas vitit 2012 dhe sidomos për atë pas vitit 2016 mund të flitet si një fazë të re të kulturës dhe politikës së kujtesës në Serbi është fakti që përveç bombardimit të NATO-s si një pikë qendrore të referimit për vëzhgimin dhe interpretimin të luftërave të viteve nëntëdhjetë, me një fokus ekskluziv te viktimat serbe dhe instrumentalizimi i tyre që ka mbizotëruar në dekadat e kaluara, mund të vihet re edhe procesi i përforcimit të heroizimit të vazhdueshëm të luftërave të viteve nëntëdhjetë dhe të interpretimit të tyre si luftëra mbrojtëse dhe çlirimtare. Kjo i referohet në veçanti

luftës në Kosovë (1998-1999). Ky proces mund të ndiqet pikërisht mbi shembullin e formësimit narrativ të luftimeve në Koshare dhe të përshtatjes së tyre në narrativin mitik të heroizmit, cenimit dhe martirizimit të popullit serb gjatë historisë.

Duke përjashtuar lidhjen lineare dhe më shpesh të thjeshtësuar me bombardimin e NATOS dhe statusin e Kosovës, përfaqësimi i luftimeve në Koshare në diskursin publik dhe politik përjashton çdo kontekstualizim më të gjerë të rrethanave historike dhe politiko-shoqërore të konfliktit, pjesë e të cilit janë edhe këto ngjarje. Në vend të kësaj, korniza interpretuese e ofruar bazohet mbi vëzhgimin manikeist të konflikteve si një luftë mitike midis forcave të së Mirës kundër forcave të së Keqes, “Ne” kundër “Tyre” ku të gjithë aktorët funksionojnë si metafora të kolektiviteteve homogjene të esencializuara etnike me një parashenjë të qartë duke u

mbështetur drejtpërdrejtë te stereotipat etnohistorike si një pjesë e rëndësishme të diskursit (etno)nacionalist të cenimit dhe të të qenit i rrethuar nga armiqtë. Kështu nga njëra anë, ndër të tjerave, ishin “terroristët shqiptarë”, “bishat shqiptare”, “kriminelët” dhe “hordhia”. Dhe nga ana tjetër: “Heronjtë pa mjekër”, “kalorësit serbë”, “Obiliqët nga epopeja e re serbe e ferrit” dhe “martirët (e rinj) të Kosovës” që tregojnë se “populli serb është i pampostur atëherë kur lufton i përbashkuar kundër së keqes dhe padrejtësisë dhe kur mbron më të dashurën dhe më të vyerën”. Ushtarët e rinj kështu konstruktohen si një mishërim simbolik i të gjithë popullit serb, dhe Kosharja bëhet edhe një pikë tjetër në vargun e pashmangshëm të luftës për jetë a vdekje, për “mbijetesë apo zhdukje të popullit serb” dhe “mbrojtje të së drejtës për të qenë i veçantë dhe për të ardhmen”. Kjo përforcohet akoma më tej duke u lidhur me betejat nga historia kombëtare (sidomos me Betejën e Kosovës), që kanë një status të veçantë në kujtesën kombëtare. Në këtë proces tregimet personale të ushtarëve (të rinj) që morën pjesë në luftime bëhen një imazh metonimik, së pari i të gjithë ushtarëve dhe policëve që kanë marrë pjesë në luftën në Kosovë në vitin 1999, dhe pastaj i gjithë luftës në Kosovë, dhe në hapin e radhës, të të gjitha luftërave të viteve nëntëdhjetë në zonën e Jugosllavisë. Kështu faqja e internetit të Ministrisë së Punës, Punësimit, Veteraneve dhe Çështjeve Sociale në vitin 2017 publikoi deklaratën e ministrit të atëhershëm Aleksandar Vulin në Asamblenë e Federatës së Organizatave të Veteranëve të Serbisë i cili inicioi ngritjen e monumentit të Tibor Černas, njërit prej pjesëmarrësve.

Aleksandar Vulin u shpreh se si “për herë të parë, Qeveria e Serbisë me në krye Aleksandar Vuçiq u kushtoi vëmendje problemeve të veteranëve dhe të familjeve të tyre”, si dhe që Qeveria e Serbisë nuk turpërohet për të vërtetën historike dhe se “Serbia në të kaluarën e saj gjithmonë ka bërë luftëra çlirimtare dhe ka luftuar kur ishte e sulmuar” duke përfunduar:

Sikurse Serbia nuk ka shkaktuar dhe nuk ka kërkuar fillimin e luftërave civile në zonën e ish-Jugosllavisë,

ashtu nuk ka shkaktuar, as kërkuar, e as merituar agresionin e NATO-s. Pikërisht për këto arsye, shteti i Serbisë nuk ka as edhe një arsye të vetme për t'u turpëruar para luftëtarëve të saj. Vetëm mund të krenohet me to, me luftën e tyre, e me dashurinë e tyre për vendin e tyre.

Kjo pasqyrë e luftimeve në Koshare dhe më gjerë, të luftërave të viteve nëntëdhjetë përbën një “të kaluar të dobishme” (*usable past*) për strukturat qeverisëse në shumë mënyra. Ajo përcaktohet nga interesat aktuale politike dhe dobia e saj në kontekstin e së tashmes për të paktën disa arsye. Veçimi i periudhave, epizodave dhe personazheve të caktuara historike, si dhe fshirja e të tjerëve, që mund të vihet re (edhe) në shebullin e Koshares, është një mekanizëm i dobishëm shtypës dhe /ose neutralizues i të gjitha pyetjeve potencialisht të sikletshme për të kaluarën e viteve nëntëdhjetë të cilat mund ta vënë në pikëpyetje drejtësinë e “popullit serb” dhe akoma më e rëndësishme - të politikave të implementuara gjatë 30 viteve të fundit. Narrativi mitik për vuajtjen dhe heroizmin e një populli të vogël gjatë historisë, e zhvendos çështjen e vendimeve politike të cilat, ndër të tjerave, kanë të bëjnë me luftën dhe paqen, por edhe me përgjegjësinë e atyre që i marrin vendimet, në rrafshin e fatit ose të katastrofës natyrore për të cilën nuk ekziston përgjegjësia personale dhe kolektive. Në Serbi, për shkak të vazhdimësisë ideologjike dhe personale të strukturave qeverisëse nga vitet nëntëdhjetë, ekziston një interes i drejtpërdrejtë për t'u liruar nga kjo përgjegjësi dhe për të hequr mundësinë e përlllogaritjes së bilancit shoqëror, ekonomik dhe politik të viteve nëntëdhjetë dhe të pasojave të tyre, jo vetëm ndaj vendeve fqinje, por edhe ndaj popullsisë dhe shoqërisë në Serbi. Në një kornizë të tillë, sfera e politikës pushon së qenuri praktikë dialoguese e komuniteteve politike që ka të bëjë me të gjithë pjesëtarët e shoqërisë, dhe politika konstituohet si diçka që ekskluzivisht i takon shtetit, ose një rrethi të ngushtë të përfaqësuesve të tij.

Rezultati përfundimtar i një shtjellimi të tillë është se çdo tentativë e hapjes së temave të kontestueshme në publik në nivelin e të gjithë shoqërisë dhe të ballafaqimit të opinioneve për çështjen

e së mirës së përgjithshme, qëllimeve shoqërore dhe të vlerave në procesin e brendshëm politik, shndërrohet në një akt të tradhtisë potenciale.

Njëkohësisht, atmosfera e cenimit të vazhdueshëm ekzistencial që promovohet nga idetë e tilla për historinë, e imponon nevojën për homogjenizimin dhe mobilizimin kundër atyre që shënohen si armiq nga ana e elitave të pushtetit. Kategoria e armiqve të jashtëm dhe/ose të brendshëm është e ndryshueshme dhe përshtatet me interesat aktuale politike, mospajtimi bëhet akt i tradhtisë, ndërsa dhuna konstituohet si dëça e prituri dhe legjitime. Përdorimi i tillë, i drejtpërdrejtë i shembullit të Koshares për të theksuar dallimin midis “patriotëve” dhe “tradhtarëve dhe armiqve të shtetit” mund të vihej re, për shembull, gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2022 kur Zdravko Ponoš, si kandidat presidencial i partisë opozitare *Partia e Lirisë dhe Drejtësisë (SSP)* dhe kryetar i Shtabit të Përgjithshëm të UJ 2006-2008, në mediat e regjimit përshkruhej si “nxënës anglez dhe më pas gjerman” i cili “përzuri heronjtë e Koshares nga ushtria” dhe që “donte të shkatërronte ushtrinë tonë”.

Ndërsa nga njëra anë narrativi mbizotërues për luftimet në Koshare është mjet i dobishëm (edhe) për diskualifikimin e kundërshtarëve politikë dhe më gjerë, të ndryshimeve demokratike pas datës 5 tetor të vitit 2000, ku edhe njëkohësisht u bë instrument i fuqishëm në legjitimizimin e politikave aktuale të regjimit përmes motiveve mbi “kthimin e dinjitetit” dhe “krenarisë serbe”. Kështu, gjatë fushatës në fjalë në vitin 2022, mund të shihej një bilbord ku paraqitet Ivan Antiq, një nga pjesëmarrësit e luftimeve në Koshare dhe kandidat për zgjedhjet parlamentare të listës Srpska napredna stranka (SNS) (Partia Përparimtare Serbe) “Aleksandar

Vuçiq - Së bashku mund të bëjmë gjithçka” me tekstin:

Vuçiq është i vetmi president të cilit iu kujtuam ne, HERONJTË E KOSHARES.

Nuk kisha ambicie për t’u marrë me politikë, por ftesën për t’u bërë pjesë e listës së SNS-së thjesht nuk e refuzova dot.

Stuhia që krijohet në publikun e gjerë nga tentativat e rralla, madje dhe në mediat kritike, për të zhvendosur ngjarjet në Koshare nga korniza mitike në fushën e debatit politik, tregon se narrativi mbizotërues rreth kësaj ngjarjeje korrespondon dhe me nevojat e një pjese të konsiderueshme të shoqërisë, si dhe që tejkalon marrëdhënien ndaj regjimit aktual.

Në këtë kuptim mund të flitet për konstituimin e një miti të ri politik i cili mbështetet te korniza kulturore tashmë ekzistuese dhe diskutet politike.

Njëkohësisht, dekontekstualizimi i këtyre ngjarjeve dhe identifikimi i lehtë me protagonistët e tyre ofron një hapësirë të domosdoshme për ventilimin e frustrimeve dhe inateve të grumbulluara, artikullimin e tyre në një mënyrë që të liron nga përgjegjësia dhe dhënien e kuptimit ndaj vuajtjes së përjetuar, por edhe jetës së vështirë aktuale.

Më në fund, madje dhe pa e hapur pyetjen se kush është fituesi i luftimeve në Koshare, ka shumë përgjigje të cilat mungojnë dukshëm. Pjesa më e madhe prej tyre pikërisht kanë të bëjnë me përgjegjësinë e Serbisë dhe të politikës së përfaqësuesve të saj të dikurshëm dhe aktual për luftërat jugosllave dhe rezultatet e tyre, pjesë e të cilave janë edhe jetët e humbura të ushtarëve të rinj në Koshare.

Sipas të dhënave të *Fondit për të Drejtën Humanitare* nga Beogradi dhe të *Fondit për të Drejtën Humanitare të Kosovës*, gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë në periudhën nga 24 mars deri më 10 qershor të vitit 1999, janë vrarë ose zhdukur mbi 6.200 civilë shqiptarë. Në zonën e përgjegjesisë së Brigadës së 125-të të Motorizuar (komunat Leposaviq, Mitrovicë, Zubin Potok, Skënderaj, Vushtrri, Klinë, Istog, Pejë dhe Deçan) u vranë 1.813 civilë, ndërsa 216 ende mbeten të pagjetur. Ndër civilët e vrarë janë 236 fëmijë dhe 327 gra. Zona e përgjegjesisë së Brigadës së 125-të të Motorizuar kufizohej me zonën e përgjegjesisë së Brigadës së 549-të të Motorizuar nën komandën e Bozhidar Deliqit. Në zonën e përgjegjesisë së Brigadës së 549-të të Motorizuar (Komunat Prizren, Gjakovë, Rahovec dhe Suharekë) u vranë më shumë civilë shqiptarë sesa në cilëndo zonë tjetër të përgjegjesisë së brigadave të tjera që kanë vepruar në Kosovë në vitin 1999. Në periudhën nga 24 mars deri më 10 qershor të vitit 1999 u vranë 2.174 civilë shqiptarë. Nga ky numër, 459 prej tyre janë gjetur në varrezat masive në Serbi ndërsa 357 ende mbeten të pagjetur.

Edhe Brigada e 125-të e Motorizuar edhe Brigada e 549-të e Motorizuar ishin pjesë e Korpusit të Prishtinës të Ushtrisë së Tretë të UJ-së. Deri më 25 dhjetor të vitit 1998 gjeneral nënkoloneli Nebojsa Pavkoviq ka qenë në krye të Ushtrisë së Tretë, i cili në vitin 2009 u dënua me 22 vjet burg për krimet kundër njerëzimit dhe shkeljen e ligjeve dhe zakoneve të luftës gjatë luftës në Kosovë në vitin 1999 para Tribunalit Ndërkombëtar për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi në Hagë. Ai u zëvendësua në postin e komandantit të Ushtrisë së Tretë në vitin 1998 nga komandanti i atëhershëm i Korpusit të Prishtinës, gjeneral Vladimir Lazareviq, i cili në vitin 2009 u dënua për krimet në Kosovë sipas përgjegjesisë komanduese para Tribunalit të Hagës me 15 vjet burg, ndërsa në vitin 2014 dënimi iu shkurtua në 14 vjet.
